



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:000638
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05772934

PAKR.nr.38/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.B., nga fshati, Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.63/2023, të dt.15.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.27.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.63/2023, të dt.15.12.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.63/2023, të dt.15.12.2023, është shpallur fajtor i akuzuari Sh.B., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, në të cilin dënimi është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.02.01.2023, gjerë me dt.27.11.2023.

Po ashtu i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 200 Euro, të cilin dënim është obliguar që të paguaj në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e paraparë ligjor, i njëjti do ti shndërrohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

I akuzuari është obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 50 Euro, paushallin gjyqësor shumën prej 100 Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.63/2023, i dt.15.12.2023, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, ose që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, mundësisht nën minimumin e paraparë ligjor.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.53/2024, të datës 30.01.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.63/2023, i dt.15.12.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit me dt.27.05.2024, pasi që i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar askush nga palët e njoftuara, përkundër asaj që janë njoftuar me rregull.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 pika 2.1 dhe 2.5 të KPPK, ngase kur thuhet aktgjykimi bazohet në prova të pa pranueshme, në rastin konkret i njëjti është bazuar dhe besimi u falet këtyre provave të cilat janë marrë nga organi i ndjekjes në vendin e ngjarjes, pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, që nënkupton se janë shkelur dispozitat ligjore të KPPK. Kjo ka

të bëjë me raportin e këqyrjes në vendin e ngjarjes, i cili mbanë datën 02.01.2023, ndërsa urdhri i gjykatës është lëshuar me dt.04.01.2023.

Po ashtu si shkelje është shkelja e nenit 384 par.2 pika 2.7 i KPPK, ku thuhet se aktgjykimi është marrë në kundërshtim me dispozitën ligjore, nga neni 369 par.7 të KPPK, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të qarta përkitazi me çdo pikë të aktgjykimit dhe se dispozitivit i të njëjtit është në kundërshtim me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë, nuk i ka marrë për bazë propozimet e mbrojtjes për rikualifikim juridik të veprës penale, përkundër asaj që kjo mundësi lejohet në kuptim të nenit 359 par.2 të KPPK. Duke e vlerësuar arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë provë për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarit, që nënkupton se provat që kanë shkuar në favor të të akuzuarit, të njëjtave nuk iu është falur besimi i duhur, andaj gjykata e shkallës së parë, edhe nuk ka vlerësuar esencën e përdorimit të substancave narkotike, pasi që i mbrojturi im gjatë vitit 2022, është përballur me fatkeqësi familjare, sepse jetën e ka humbur djali i tij, në një aksident trafiku, ashtu që qetësinë e ka gjetur me konsumimin e substancave narkotike.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara nga neni 384 i KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, nga neni 394 të KPPK.

Kolegji ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm, në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë tjera të aktgjykimit, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë, është përkujdesur në mënyrë të qartë që të vërtetoj elementet inkriminuese të kësaj vepre, për të cilën i akuzuari është akuzuar. Po ashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme që në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale të përshkruara më lartë, e cila rezulton nga të gjitha shkresat e lëndës, sikurse janë provat personale, po ashtu edhe ato materiale. Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të gjitha veprimet gjatë të gjitha fazave të procedurës, dhe ka ardhur në përfundim që të njëjtat janë ndërmarrë me përputhshmëri nga dispozitat përkatëse ligjore, ashtu që pretendimet e mbrojtësit së të akuzuarit nuk kanë bazë juridike, pasi që gjatë punës janë vlerësuar dhe në mënyrë të qartë dhe të plotë, janë zbatuar sikurse kërkojnë dispozitat ligjore të KPPK. Në këtë çështje penale që të gjitha institucionet të cilat kanë zhvilluar procedurë kanë përmbushur detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, dhe se saktësisht kanë paraqitur vërtetimin e elementeve të veprës penale, ashtu që në kuptim të nenit 364 të KPPK, me rastin e marrjes së aktgjykimit dënues, gjykata e shkallës së parë pasi që ka vërtetuar se janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale, për të cilën e ka shpallur fajtor të akuzuarin, ka ardhur në përfundim se janë formuluar elementet inkriminuese pasi që janë vërtetuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPK.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, andaj aktgjykimi është hartuar në pajtim me dispozitën ligjore nga neni 369 i KPPK, sepse për çdo pikë të aktgjykimit janë paraqitur arsye të qarta dhe të sakta, si dhe gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të qartë saktësinë e secilës provë, e cila ka qenë domethënëse për të vendosur çështjen penale. Gjatë vlerësimit të aktgjykimit, kolegji ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, janë dhënë arsyet për mos miratimin e ndonjë propozimi nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, që kanë qenë pjesë përbërëse e formimit të elementeve inkriminuese të veprës penale.

Në rastin konkret duke pasur parasysh që i akuzuari Sh.B., është konsumues i substancave narkotike – marihuan, afër tij janë gjetur pesë paketime të substancës narkotike, që nënkupton se kanë qenë të destinuara për tu shpërndarë.

Pasi që janë formuluar elementet qenësore të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, kolegji ka ardhur në përfundim se me këtë çështje penale, nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e ka mbështetjen e duhur ligjore.

Për shkak të shkeljeve të ligjit penal, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga ana e mbrojtësit të akuzuarit Sh.B., av. Shaban Gashi, duke pretenduar se në veprimet e të akuzuarit nuk janë formuluar elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, ngase dispozitivi nuk bënë përshkrimin e asnjë veprimi inkriminues, i cili i vihet në barrë të akuzuarit, dhe se të gjitha veprimet që përkasin elementet e veprës penale, janë më tepër elemente të veprës penale, nga neni 269 të KPK, të cilën çështje gjykata e shkallës së parë është dashur që ta vlerëson, e jo të shpallet fajtor për veprën penale nga neni 267 par.1 të KPK, sepse i mbrojturi im asnjëherë nuk ka ofruar substancë narkotike për shitje, apo të ketë shitur.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtuar përkitazi me shkeljet e ligjit penal, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të pa dyshimtë, ka vërtetuar se i akuzuari Sh.B., ka kryer veprën penale pasi që ka proceduar dhe vlerësuar të gjitha provat personale dhe materiale se i akuzuari Sh.B., ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, e jo veprën penale sikurse pretendon mbrojtësi i të akuzuarit nga neni 269 të KPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shkeljet e ligjit penal, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e parapara nga neni 385 i KPPK, sepse nga vlerësimi i veprimeve të ndërmarra nga i akuzuari, rezulton se i njëjti substancën të cilën e ka gjetur në kontejner e ka marrë, dhe e ka nda në pjesë të tjera, me qëllim që të njëjtën ta ekspozon për shitje. Kolegji po ashtu ka ardhur në përfundim se me aktgjykimin e nxjerrë nuk janë manifestuar elementet e shkeljes së ligjit penal, sepse vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor është e parapare me ligjin e aplikueshëm penal, se nuk ka gjetur arsye të cilat e përjashtojnë të akuzuarin nga ndjekja penale, si dhe përgjegjësia penale,

se gjatë marrjes së vendimit për dënimin, dënimit plotësues, gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara.

Edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, e ka ankimuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke theksuar se në këtë çështje penale në bazë të provave të cilat janë proceduar dhe janë vlerësuar, rezulton se në veprimet e të akuzuarit nuk janë formuluar elementet qenësore të veprës penale nga neni 267 par.1 të KPK, por elementet e veprës penale, nga neni 269 të KPK. Po ashtu edhe sipas raportit të ekspertimit të AFK, ku i është bërë analiza e ADN-së, dëshmisë së gjashtë (gjysmë cigare me substancë të dyshuar), është konstatuar se është fituar profili i ADN-së së përzier, duke rezultuar se kontribuues kryesor është një pëson i pa njohur i gjinisë femërore, andaj kjo rrethanë ka mbetur pa u vërtetuar. Edhe nga raporti i ekspertimit AKF/2023-0055/23-43, të dt.26.04.2023, kur është bërë nxitja e gjurmëve papilare, nga dëshmia D1-4,5, dhe 6 është konstatuar se nga të gjitha dëshmitë nuk është nxjerrë asnjë gjurmë e vijave papilare, andaj është e pa qartë se në çfarë mënyre është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Që të gjitha këto mangësi, qojnë në drejtim të asaj se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, por vetëm është bazuar aktgjykimi në dëshminë e dëshmitarit Kastriot Bajraj, e cila është në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkritazi me gjendjen faktike dhe ka ardhur në përfundim, se e njëjta është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ngase me të gjitha provat materiale dhe personale, me të cilat gjykata i ka proceduar dhe vlerësuar, në mënyrë të pa dyshim të është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK. Po ashtu në bazë të deklaratave të cilat gjykata e shkallës së parë i ka proceduar dhe i ka vlerësuar, vihet në përfundim se në këtë çështje penale i akuzuari Sh.B., ka kryer veprën penale, nga neni 267 par.1 të KPK dhe kjo pas vlerësimit të deklaratës së dëshmitares Diamante Dukollaj, e cila ka pranuar që në shtëpi është gjetur substanca narkotike, e cila ndërlidhet edhe me deklaratën e dëshmitarit K.B., i cili ka deklaruar se ka konsumuar narkotik së bashku me Shpejtimin, dhe se Shpejtimi ka shitur narkotik. Kjo vërtetohet edhe nga të gjitha provat materiale që janë pjesë përbërëse e aktgjykimit, sikurse janë raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i dt.02.01.2023, lëshuar me dt.03.01.2023, të paraqitura si dëshmi nga 1-6, duke paraqitur karakteristikat e secilës dëshmi, fotografive nga vendi i ngjarjes, nga të cilat rezulton se dhomat ku është gjetur substancave narkotike dhe të njëjtë të fotografuara me dt.02.01.2023, raporti i ekspertimit AKF2023-0055/23-42, i dt.18.04.2023, ku është bërë analiza e ADN-së, nga dëshmia 6 (gjysmë cigare me substancë të dyshuar), raporti i ekspertimit AKF, i dt.26.04.2023, të dëshmimeve D1,D4,D5 dhe D6, ku është bërë nxitja e gjurmëve të vijave papilare, raporti informues i analizës së telefonave nr.06/2-02258/23, i dt.06.02.2023, raporti i ekspertimit AKF2023-006, i dt.17.01.2023, CDAKF-2023-006, në të cilin janë konstatuar të gjeturat në telefonin “Samsung” SM-A510F, imei 358170076121820, të dhënat e siguruara nga listingu i operatorit “IPKO”, nr.+383 43 91 82 19, i regjistruar në emër të D.D., ashtu që të gjitha këto prova në mënyrë të pa padyshim të pasi që janë vlerësuar, kanë vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale për të cilën është akuzuar.

Edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, është ankimuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, duke theksuar se dënimi me burgim i shqiptuar të akuzuarit, në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, është i ashpër dhe se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, por vetëm ato rënduese, e sidomos ka theksuar se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë, por jo për këtë lloj të veprave penale. Duke pasur parasysh këtë rrethanë është dashur që ti shqiptohet dënim më i butë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.B., av.Shaban Gashi, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton se është vërtetuar pasi që janë vërtetuar dhe vlerësuar të gjitha provat nga shkresat e lëndës, sikurse ato materiale dhe ato personale, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike, se jeton në kushte të dobëta ekonomike, kurse si rrethana rënduese ka pasur parasysh se i njëjti ka qenë i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, P.nr.170/2021, të dt.27.09.2021, është shpallur fajtor dhe është dënuar për vepra penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPK, po ashtu edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2024/2020, të dt.19.12.2022, i shpallur fajtor dhe dënuar për veprën penale dhuna në familje, nga neni 248 të KPK, e duke pasur parasysh edhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkalën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, kolegji i kësaj gjykate pasi që nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, është i bindur se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.38/2024, të datës 27.05.2024

Procesmbajtës,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani